



Pranuar / Dorezuar Priljena/Prudato Received/Delivety	18.05.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMESHICK	2901/2022		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.328/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.328/2022 të datës 05.04.2022, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi fshati kundër organit të punësimit Policia e Kosovës, në çështjen juridike "ndërprerja e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 18.05.2022, në mënyrë unanime mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.328/2022 e datës 05.04.2022 e parashtruar nga ankuesja

II.Shfuqizohet Vendimi me numër KDNSHC-05/007/2022 i datës 11.03.2022,i Komisionit Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Civil në Policinë e Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesja është e punësuar në Policinë e Kosovës, në bazë të kontratës së punës me numër 0419 të datës 14.05.2004, në pozitën "Asistente administrative", Njësia-Veriu, në Drejtorinë Rajonale të Policisë në Mitrovicë .

Me datën 10.01.2022, Mbikëqyrësi në Operativ pranë Stacionit Policor në Mitrovicën e sipas shkresës zyrtare me numër 04/1-07-Ro-003/2022, ka iniciuar procedurën disiplinore ndaj ankueses

Koordinatori për trajtimin e rasteve të nivelit lokal, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës me datën 18.01.2022 ka proceduar lëndën e ankuësës për tek sekretaria e Komisionit Disiplinor.

Komisioni Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Civil në Policinë e Kosovës, me datën 18.02.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër KDNSHC-05-01-2022, sipas të cilit ka shtyrë afatin për shqyrtimin e lëndës lidhur me procedurën disiplinore ndaj ankueses, ndërsa me datën 11.03.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër KDNSHC-05/007/2022, sipas të cilit vendim ankuesen e ka shpallur përgjegjëse dhe i ka shqiptuar masën disiplinore "Largim nga shërbimi civil".

E pakënaqur me Vendimin me numër KDNSHC-05/007/2022 të datës 11.03.2022 nga Komisioni Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Civil në Policinë e Kosovës, me datën 05.04.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1854/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të aplikimit të së drejtës materiale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe vendimit lidhur me masën disiplinore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 08.04.2022, ka proceduar kërkesën me numër të protokollit 1992/2022 për përgjigje në ankesë tek Policia e Kosovës, ndërsa me datën 21.04.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga ky institucion së bashku me provat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1854/2022 të datës 05.04.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Raport mjekësor i datës 13.12.2021; Raport mjekësor i datës 14.12.2021; Raport mjekësor i datës 26.01.2022; Raport mjekësor i datës 01.03.2022; Raport mjekësor i datës 05.12.2019; Raport mjekësor i datës 03.12.2019; Certifikatë e datës 24.03.2022 mbi kryerjen e covidit; Vendimin me numër KDNSHC-05/007/2022 të datës 11.03.2022 të Komisionin Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Civil në Policinë e Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 08.04.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 21.04.2022 nga Policia e Kosovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Formularin PDP mbi përshkrimin e detyrave të punës së ankueses të datës 02.06.2015; Regjistrimin e hyrje daljeve në punë për ankuesen të datës 09.12.2021;

Regjistrimin e hyrje daljeve në punë për ankuesen të datës 10.12.2021; Regjistrimin e hyrje daljeve në punë për ankuesen të datës 13.12.2021; Regjistrimin e hyrje daljeve në punë për ankuesen të datës 14.12.2021; Regjistrimin e hyrje daljeve në punë për ankuesen të datës 15.12.2021; Regjistrimin e hyrje daljeve në punë për ankuesen të datës 16.12.2021; Regjistrimin e hyrje daljeve në punë për ankuesen të datës 17.12.2021; Regjistrimin e hyrje daljeve në punë për ankuesen të datës 20.12.2021;

Regjistrimin e hyrje daljeve në punë për ankuesen të datës 21.12.2021; Regjistrimin e hyrje daljeve në punë për ankuesen të datës 22.12.2021; Regjistrimin e hyrje daljeve në punë për ankuesen të datës 23.12.2021; E-mailin zyrtar të datës 15.04.2022; E-mailin zyrtar të datës 14.04.2022; Raportin mjekësor të datës 26.01.2022; Raportin mikrobiologjik të datës 28.02.2022; Ftesën e datës 08.03.2022 lidhur me seancën dëgjimore për në Komisionin Disiplinor; Vendimin me numër KDNSHC-05-01-2022 te datës 18.02.2022 nga Komisionit Disiplinor; Procesverbalin e datës 11.03.2021 për seancën dëgjimore; Kërkesën e datës 08.03.2022 përmes e-mailit zyrtar; Shkresën zyrtare të datës 18.01.2022 lidhur me procedimin e lëndës së ankueses për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës; Shkresën zyrtare të datës 10.01.2022 lidhur me procedimin e lëndës së ankueses nga Drejtoria Rajonale e Policisë-Mitrovicë e Veriut; Formularin e datës 10.01.2021 lidhur me paraqitjen e disiplinës së brendshme për ankuesen; Deklaratën e ankueses të datës 09.12.2021.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses _____ është e bazuar sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka analizuar procedurën lidhur me përgjegjësinë disiplinore dhe procedimin e lëndës së ankueses për Komisionin Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Civil në Policinë e Kosovës; ka konstatuar se me datën 11.01.2022 Shefi i Sektorit të Operatives në Mitrovicën e Veriut, ka iniciuar procedurën disiplinore për ankuesen përmes formularit të paraqitjes për disiplinën e brendshme, të inicuar nga personi përgjegjës për zbatimin e masave anticovid, për tek Drejtoria e Hetimit të Brendshëm dhe Verifikimit të së Kaluarës në Prishtinë. Ndërsa me datën 18.01.2022, Koordinatorin për Trajtimin e Rasteve të Nivelit Lokal përmes Drejtorit të Drejtorisë për Hetime të Brendshme dhe Verifikim të së Kaluarës në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë e ka proceduar lëndën e ankueses për tek Sekretaria e Komisionit Disiplinor në Prishtinë. Me datën 11.03.2022, Komisioni Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Civil në Policinë e Kosovës, ka nxjerrë Vendimin me numër KDNSHC-05/007/2022 sipas të cilit ankuesen e ka shpallur përgjegjëse dhe i ka shqiptuar masën disiplinore "*Largim nga Shërbimi Civil*".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, fillimisht ka analizuar ligjshmërinë e Vendimit me numër KDNSHC-05-01-2022 të datës 18.02.2022, vendim ky i nxjerrë nga Komisioni Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Civil në Policinë e Kosovës, me të cilin ka vendosur që të shtyhet afati lidhur me shqyrtimin e lëndës disiplinore me numër KDNSHC-05-01-03-2022 ndaj ankueses, me arsyetimin se njëri nga anëtarët e këtij komisioni ka qenë i infektuar me covid si dhe lënda e ankueses është dërguar për përkthim pasi që është inicuar në gjuhën serbe. Ndërlidhur me ligjshmërinë e këtij vendimi, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se paragrafi 1 i nenit 99 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka përcaktuar saktësisht se në cilat raste mund të shtyhet afati lidhur me një procedurë, ku theksohet se: "*1. Përveç kur ndalohet shprehimisht me ligj, nëse është e nevojshme për shkak të kompleksitetit të çështjes administrative konkrete, organi publik mund të shtyjë, vetëm një herë, afatin fillestar të paraparë për përfundimin e procedurës administrative, sipas nenit 98 të këtij Ligji*". andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se për rastin konkret të ankueses nuk janë përmbushur kushtet ligjore nga ky nen lidhur me kompleksitetin e lëndës, sepse mungesa e anëtarit të komisionit nuk përben shkak për shtyrjen e afatit të vendosjes, ngase i njëjti ka mundur të zëvendësohet me anëtarin tjetër e jo të shtyhet vendim marrja lidhur me këtë lëndë. Kolegji me këtë rast ka vlerësuar se Komisioni Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Civil në Policinë e Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KDNSHC-05-01 2022 të datës 18.02.2022, kur ka vendosur lidhur me shtyrjen e afatit për lëndën e ankueses, gabimisht i u është referuar dispozitave të nenit 98 dhe 99 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase në nenin 98 të po këtij ligji theksohet fakti se kjo dispozite i referohet trajtimit të kërkesave të natyrës administrative e jo afatit të vendimmarrjes nga ana e Komisionit Disiplinor, prandaj Kolegji ka konstatuar se afati lidhur me vendosjen nga ana e Komisionit Disiplinor është e rregulluar në bazë të nenit 12 paragrafit 6 të Rregullores (QRK) NR.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, po ashtu ka analizuar Vendimin me numër KDNSHC-05/007/2022 të datës 11.03.2022, i nxjerrë nga Komisioni Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Civil në Policinë e Kosovës, sipas të cilit ankuesen e ka shpallur përgjegjëse dhe i ka shqiptuar masën disiplinore "*Largim nga Shërbimi Civil*" mbi arsyetimin se e njëjta ka munguar në punë nga data 09 deri me 23.12.2021 pa arsye. Ndërlidhur me këtë ka konstatuar se, iniciimi mbi

procedurën disiplinore të ankueses fillimisht është bërë me datën 11.01.2022 nga Shefi i Sektorit të Operatives në Mitrovicën e Veriut për tek Drejtoria e Hetimit të Brendshëm dhe Verifikimit të së Kaluarës në Prishtinë, ndërsa ky i fundit lëndën e ankueses e ka përcjellë për tek Sekretaria e Komisionit Disiplinor me datën 18.01.2022. Ndërsa ndërlidhur me afatshmërinë e rrjedhës së procedurës lidhur me vendosjen për lëndën e ankueses nga ana e Komisionit Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Civil në Policinë e Kosovës sipas Vendimit me numër KDNSHC-05/007/2022 i datës 11.03.2022, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se ky vendim është nxjerrë në kundërshtim me nenin 12 paragrafin 6 të Rregullores (QRK) NR.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtareve Publikë, në të cilën decidivisht theksohet se: *“Komisioni disiplinor duhet të marrë vendim brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës për inicim të procedurës nga njësia për burime njerëzore”*, sepse i njëjti është nxjerrë me datën 11.03.2022, pas dy (2) muajve konkretisht, prej datës 10.01.2022 (përkundër që në kërkesë për inicim është e shënuar gabimisht data 10.01.2021), kur është bërë fillimisht inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankueses, ndërsa edhe nëse marrim parasysh se në vendimin e komisionit disiplinor të Policisë së Kosovës tek pjesa e parë e arsytimit të njëjtit kanë potencuar faktin se inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankueses e kanë pranuar më datë 04/02/2022, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se i njëjti është nxjerrë në kundërshtim me nenin 12 paragrafin 6 të Rregullores (QRK) NR.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtareve Publikë respektivisht jashtë afatit ligjor si dhe në kundërshtim edhe me nenin 52 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative lidhur me paligjshmërinë e të njëjtit si akt administrativ.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në kuptim të nenit 52 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, meqenëse ka konstatuar paligjshmërinë e aktit administrativ respektivisht Vendimin me numër KDNSHC-05/007/2022 të datës 11.03.2022, i nxjerrë nga Komisioni Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Civil në Policinë e Kosovës për rastin e ankueses lidhur me përgjegjësinë disiplinore të saj, mbi këtë bazë nuk është lëshuar fare në pretendimet ankimore të ankueses, si dhe vendimmarrjen nga i njëjti komision.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmer veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.





Pranuar / Dostiguar Priljepljen / Priljepljen Received / Delivered	18-05-2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	No Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTHCX	2901/2022		115



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.br.328/2022

Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova- Veće za razmatranje i rešavanje žalbi sastavu: Arben Mehmeti-predsednik, Ardita Haxhnikaj-Demi i Jeton Koca- članovi, i Ardita Perçuku-Shyti-viša službenica za stručnu saradnju u svojstvu zapisničarke, razmotrilo je žalbu A.br.328/2022 od dana 05.04.2022.godine, podneta od žalioaca [redacted] adresa stanovanja selo "Zupče" Opština Zubin Potok, protiv organa poslodavca Policije Kosova, po pravnoj stvari "prekid radnog odnosa", postupajući u skladu sa članom 6. stav 1 podstav 1.1. članom 16. stav 3, članom 18. stav 1 podstav 1.2 Zakona br.06/L-048 o Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova i Pravilnika br.02/2018 o Pravilima i Žalbenim procedurama u Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova, na sednici za većanje i glasanje održane dana 18.05.2022.godine, jednoglasno je donelo ovu:

ODLUKU

- I. Usvaja kao osnovana žalba broj A.br.328/2022 od dana 05.04.2022.godine podneta od žalioaca [redacted]
- II. Stavlja se van snage odluka KDNSHC-05/007/2022 od dana 11.03.2022.godine Disciplinske komisije za službenike civilne službe u Policiji Kosova.

O b r a z l o ž e n j e

Žalioc [redacted] zaposlena je u Policiji Kosova, na osnovu ugovora o radu broj 0419 od dana 14.05.2004.godine na radnom mestu- Administrativna asistentica, Jedinica- Sever, u Regionalnoj Policiji u Mitrovici.

Dana 10.01.2022.godine, nadzornik u Operativi u Policijskoj stanici u Severnoj Mitrovici Jevđić Predrag, prema službenom dopisu broj 04/1-07-Ro-003/2022, pokrenuo je disciplinski postupak protiv žalioaca [redacted]

Koordinator za razmatranje slučajeva na lokalnom nivou, iz Generalne direkcije Policije Kosova, dana 18.01.2022.godine procesuirao je predmet žalioaca u Sekretarijat disciplinske komisije.

Disciplinska komisija za službenike civilne službe u Policiji Kosova, dana 18.02.2022.godine donela je Odluku KDNSHC-05-01-2022, prema kojoj je produžila rok za razmatranje predmeta u vezi disciplinskog postupka protiv žalioca, dok je dana 11.03.2022.godine donela Odluku broj KDNSHC-05/007/2022, prema kojoj odluci podnosioca žalbe je proglasila odgovornom i izrekla joj je disciplinsku meru "Udaljavanje iz civilne službe".

Nezadovoljna Odlukom broj KDNSHC-05/007/2022 od dana 11.03.2022.godine doneta od Disciplinske komisije za službenike Civilne službe u Policiji Kosova, dana 05.04.2022.godine, podnela je žalbu broj protokola 1854/2022 u Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova, zbog primene materijalnog prava, pogrešno utvrđenog činjeničnog stanja i odluke u vezi disciplinske mere.

Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova, dana 08.04.2022.godine procesuirao je zahtev sa brojem protokola 1992/2022 radi davanja odgovora na žalbu u Policiju Kosova, dok dana 21.04.2022.godine Odbor je primio odgovor na žalbu iz ove institucije zajedno sa dokazima predmeta.

Veće za razmatranje i rešavanje žalbi, za meritorno odlučivanje utvrdilo je sledeće dokaze: Žalbu broj protokola 1854/2022 od dana 05.04.2022.godine podneta od strane podnosioca žalbe u Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova; Lekarski izveštaj od dana 13.12.2021.godine; Lekarski izveštaj od dana 14.12.2021.godine; Lekarski izveštaj od dana 26.01.2022.godine; Lekarski izveštaj od dana 01.03.2022.godine; Lekarski izveštaj od dana 05.12.2019.godine; Lekarski izveštaj od dana 03.12.2019.godine; Potvrdu od 24.03.2022.godine o preležanom covidu; Odluku broj KDNSHC-05/007/2022 od dana 11.03.2022.godine doneta od Disciplinske komisije za službenike civilne službe u Policiji Kosova; Zahtev za odgovor na žalbu od dana 08.04.2022.godine od Nezavisnog nadzornog odbora civilne službe Kosova; Odgovor na žalbu od 21.04.2022.godine iz Policije Kosova sa priloženim spisima predmeta; Formular PDP o opisu radnih zadataka žalioca od dana 02.06.2015.godine; Registar dolaska i odlaska sa posla za žalioca od dana 09.12.2021.godine; Registar dolaska i odlaska sa posla za žalioca od dana 10.12.2021.godine; Registar dolaska i odlaska sa posla za žalioca od 13.12.2021.godine; Registar dolaska i odlaska sa posla za žalioca od 14.12.2021.godine; Registar dolaska i odlaska sa posla za žalioca od 15.12.2021.godine; Registar dolaska i odlaska sa posla za žalioca od 16.12.2021.godine; Registar dolaska i odlaska sa posla za žalioca od 17.12.2021.godine; Registar dolaska i odlaska sa posla za žalioca od 20.12.2021.godine; Registar dolaska i odlaska sa posla za žalioca od 21.12.2021.godine; Registar dolaska i odlaska sa posla za žalioca od 22.12.2021.godine; Registar dolaska i odlaska sa posla za žalioca od 23.12.2021.godine; Službeni e-mail od 15.04.2022.godine; Službeni email od 14.04.2022.godine; Lekarski nalaz od dana 26.01.2022.godine; Mikrobiološki nalaz od dana 28.02.2022.godine; Poziv od dana 08.03.2022.godine u vezi rasprave saslušanja za disciplinsku komisiju; Odluku broj KDNSHC-05-01-2022 od dana 18.02.2022.godine disciplinske komisije; Zapisnik od 11.03.2021.godine za raspravu saslušanja; Zahtev od 08.03.2022.godine preko službenog emaila; Službeni dopis od dana 18.01.2022.godine u vezi procesuiranja predmeta žalioca za Generalnu direkciju Policije Kosova; Službeni dopis od dana 10.01.2022.godine u vezi procesuiranja predmeta žalioca iz Regionalne direkcije Policije –Severna Mitrovica; Obrazac od dana 10.01.2021.godine; u vezi prijave unutrašnje discipline protiv žalioca; Izjavu podnosioca žalbe od dana 09.12.2021.godine.

Veće za razmatranje i rešavanje žalbi, nakon što je razmotrilo spise predmeta podnete od stranaka u postupku, utvrdilo je da je žalba podnosioca žalbe **osnovana, jer:**

Veće za razmatranje i rešavanje žalbi, nakon što je analiziralo postupak u vezi disciplinske odgovornosti i procesuiranje predmeta žalioca za disciplinsku komisiju za službenike civilne službe u Policiji Kosova, utvrdilo je da je dana 11.01.2022.godine, šef Sektora operative u Severnoj Mitrovici, pokrenuo disciplinski

postupak protiv podnosioca žalbe na osnovu formulara za prijavljivanje unutrašnje discipline, pokrenut od odgovornog lica za sprovođenje anticovid mera, u Direkciji za unutrašnju istragu i proveru prošlosti u Prištini. Dana 18.01.2022.godine, koordinator za razmatranje slučajeva Lokalnog nivoa, preko direktora Direkcije za unutrašnju istragu i proveru prošlosti u Generalnoj direkciji Policije, procesuirao je predmet žalioca u Sekretarijat disciplinske komisije u Prištini. Dana 11.03.2022.godine, disciplinska komisija za službenike civilne službe u Policiji Kosova, donela je Odluku broj KDNSHC-05/007/2022, prema kojoj je žalioca proglasila odgovornom i izrekla joj disciplinsku meru “**Udaljavanje iz civilne službe**”.

Veće za razmatranje i rešavanje žalbi, najpre je analiziralo zakonitost Odluke broj KDNSHC-05-01-2022 od dana 18.02.2022.godine, odluka koja je doneta od disciplinske komisije za službenike civilne službe u Policiji Kosova, u kojoj je odlučila da produži rok u vezi razmatranja disciplinskog predmeta broj KDNSHC-05-01-03-2022 protiv žalioca, uz obrazloženje da je jedan od članova ove komisije bio zaražen covidom i da je predmet podnosioca žalbe prosleđen na prevod, pošto je pokrenut na srpskom jeziku. Vezano za zakonitost ove odluke, Veće za razmatranje i rešavanje žalbi, utvrdilo je da je stav 1 člana 99. Zakona br.05/L-031 o Opštem upravnom postupku, tačno utvrdio u kojim slučajevima se može produžiti rok u vezi jednog postupka, gde se navodi da: “**Osim kada je zakonom izričito zabranjeno, ako je neophodno zbog složenosti konkretnog administrativnog pitanja, javni organ može odložiti, samo jednom, početni rok predviđen za okončanje upravnog postupka, shodno članu 98 ovog zakona**”, dakle, Veće za razmatranje i rešavanje žalbi, utvrdilo je da u konkretnom slučaju podnosioca žalbe, nisu ispunjeni zakonski uslovi iz ovog člana u vezi složenosti predmeta, jer odsustvo člana komisije nije razlog za odlaganje roka za odlučivanje, pošto je isti mogao biti zamenjen drugim članom, a ne da se odloži odlučivanje u vezi ovog predmeta. U ovom slučaju, Veće je u ovom slučaju ocenilo da je disciplinska komisija za službenike civilne službe u Policiji Kosova, prilikom donošenja Odluke broj KDNSHC-05-01-2022 od dana 18.02.2022.godine, kada je odlučila u vezi produženja roka za predmet žalioca, pogrešno se pozvala na odredbe člana 98. i 99. Zakona br.05/L-031 o Opštem upravnom postupku, pošto se u članu 98. ovog zakona navodi činjenica da se ova odredba odnosi na razmatranje zahteva upravne prirode, a ne na rok odlučivanja od strane disciplinske komisije, dakle Veće je utvrdilo da je rok u vezi odlučivanja od strane disciplinske komisije regulisan na osnovu člana 12. stav 6 Uredbe (VRK) br.11/2020 o Disciplini i Žalbama javnih službenika.

Veće za razmatranje i rešavanje žalbi, takođe je analiziralo Odluku broj KDNSHC-05/007/2022 od dana 11.03.2022.godine, doneta od disciplinske komisije za službenike civilne službe u Policiji Kosova, prema kojoj je podnosioca žalbe proglasila odgovornom i izrekla joj disciplinsku meru “Udaljavanje iz Civilne službe”, uz obrazloženje da je ista bila neopravdano odsutna sa posla od 09 do 23.12.2021.godine. S’ tim u vezi, utvrdilo je da je pokretanje disciplinskog postupka protiv žalioca, najpre je urađeno dana 11.01.2022.godine od šefa Sektora Operative u Severnoj Mitrovici za Direkciju za Unutrašnju istragu i Proveru prošlosti u Prištini, dok je ova potonja predmet prosledila u Sekretarijat disciplinske komisije dana 18.01.2022.godine. Međutim, nadovezujući se na blagovremenost toka postupka u vezi odlučivanja o predmetu podnosioca žalbe od strane disciplinske komisije za službenike civilne službe u Policiji Kosova, shodno Odluci broj KDNSHC-05/007/2022 od dana 11.03.2022.godine, Veće za razmatranje i rešavanje žalbi, utvrdilo je da je ova odluka doneta u suprotnosti sa članom 12. stav 6 Uredbe (VRK) br.11/2020 o Disciplini i Žalbama javnih službenika, u kojoj se definitivno navodi da: “**Disciplinska komisija treba da donese odluku u roku od 30 dana nakon primanja zahteva za pokretanje postupka od jedinice za ljudske resurse**”, jer je ista doneta dana 11.03.2022.godine, nakon dva (2) meseca, konkretnije od dana 10.01.2022.godine (uprkos što je u zahtevu za pokretanje pogrešno upisan datum 10.01.2021), kada je najpre urađeno pokretanje disciplinskog postupka protiv žalioca, međutim, iako uzmemo u obzir da u odluci disciplinske komisije Policije Kosova u prvom delu obrazloženja, isti su naglasili činjenicu da su pokretanje disciplinskog postupka protiv žalioca primili dana 04/02/2022.godine, Veće za razmatranje i

rešavanje žalbi, utvrdilo je da je ista doneta u suprotnosti sa članom 12. stav 6 Uredbe (VRK) br.11/2020 o Disciplini i Žalbama javnih službenika odnosno izvan zakonskog roka kao i u suprotnosti sa članom 52. br.05/L-031 o Opštem upravnom postupku u vezi nezakonitosti istog upravnog akta.

Veće za razmatranje i rešavanje žalbi, u smislu člana 52. Zakona br.05/L-031 o Opštem upravnom postupku, nakon što je utvrdilo nezakonitost upravnog akta odnosno Odluku broj KDNSHC-05/007/2022 od dana 11.03.2022.godine, doneta od disciplinske komisije za službenike civilne službe u Policiji Kosova, o slučaju podnosioca žalbe u vezi njene disciplinske odgovornosti, na toj osnovi, nije se uopšte upustilo u žalbene tvrdnje žalioaca, kao i na odlučivanje od strane iste komisije.

U slučaju nesprovođenja odluke Odbora od strane odgovornog lica definisano u dispozitivu ove odluke, predsednik Odbora preuzima radnje u skladu sa članom 21, 23, i 24. Zakona br.06/L-048 o Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova, primenjujući i obustavu 50% mesečne plate za odgovorno lice, do sprovođenja odluke Odbora.

Nakon razmatranja predmetnih spisa, zasnivajući se na član 18. stav 1 podstav 1.2 Zakona br.06/L-048 o Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova, Veće je odlučilo kao u dispozitivu ove odluke.

Odluka stupa na snagu na dan potpisivanja od strane predsednika Veća.

Pravna pouka: Protiv odluke Odbora, nezadovoljna stranka koja tvrdi da je odluka Odbora nezakonita, može pokrenuti upravni spor u nadležni Sud, Osnovni sud u Prištini- Odeljenje za administrativne poslove u roku od trideset (30) dana od dana kada joj je predata odluka. Pokretanje upravnog spora ne zadržava izvršenje odluke Odbora.

NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILE SLUŽBE KOSOVA
Predmet broj A.br.328/2022 od dana 18.05.2022.god.

Ardita Perçuku -Shyti

Arben MEHMETI

Viša službenica za stručnu saradnju


Predsednik Veća

Odluku dostaviti:

- Žaliocu
- Generalnom direktoru Policije Kosova;
- Kadrovskom rukovodiocu u Policiji Kosova i
- Arhivi NNOCSK-a.

Preveo:

Sh.Mujko


Dana, 19.05.2022.god.